



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 nëntor 2011
Nr. ref.: RK149/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 01/11

Parashtruesi

Ndërmarrja private “Građevinar”

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Ae -Pž nr.21/2008, të 15 korrikut 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është ndërmarrja private „Građevinar“ nga Kraleva, që përfaqësohet nga avokati Miro Delević, nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ae-Pž br.21/2008, i 15 korrikut 2010, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV P-nr.11/2005, të 11 korrikut 2007, në lidhje me kërkesën e parashtruesit për dëmshpërblim për shkak të dëmit të shkaktuar si pasojë e shkatërrimit të pronës, gjatë dhe menjëherë, pas veprimeve luftarake të vitit 1999.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ae-Pž nr.21/2008, të 15 korrikut 2010, duke mos përmendur ndonjë nen konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës pohon se shkelja e të drejtës qëndron në faktin se *„në çdo kohë dhe në të gjitha rastet e drejta duhet të ekzistojë dhe se ekzistenca e së drejtës gjithnjë ofron mbrojtje për personat fizikë dhe juridikë si dhe ngrit çështjen e përgjegjësisë“*.

Baza juridike

4. Kërkesa është parashtruar në bazë të neneve 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, neneve 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës më 5 janar 2011 paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 mars 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi z. Miro Delević, Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë se është iniciuar procedura për lëndën nr. KI-01-11.
7. Më 28 mars 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë në përgjigjen drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka theksuar se nuk ka asgjë të re për të shtuar dhe se mendimi i saj për objektin e çështjes është paraqitur në aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.
8. Më 29 mars 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në përgjigjen drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka theksuar se nuk ka asgjë të re për të shtuar dhe se mendimi i saj mbi objektin e çështjes është paraqitur në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 5 prill 2011, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga avokati Miro Dalević që të dorëzojë prova mbi datën e pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae-P ž nr. 21/, të datës 15 korrik 2010.

10. Më 26 prill 2011, avokati Miro Delević në përgjigjen me shkrim ka njoftuar Gjykatën Kushtetuese se fletëdorëzimi për pranimin e aktgjyqimit gjendet në Gjykatën Supreme të Kosovës.
11. Më 28 qershor 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut, me anë të faksit, ka dërguar fletëdorëzimin në të cilin shihet se avokati Miro Delević e ka marrë aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 22 shtator 2010.
12. Më 4 tetor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami, i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Ndërmarrja private „Gradevinar“, nga fshati Ratinë, Komuna e Krlevës, e cila gjatë vitit 1999 ka zhvilluar veprimtari afariste në Komunën e Obiliqit, ka paraqitur kërkesë-padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me të cilën kërkon nga Komuna e Prishtinës-si e paditura e parë, nga Institucionet e Përkohshme të Kosovës-si e paditura e dytë dhe nga Qeveria e Kosovës-si e paditura e tretë, që ndërmarrjes private „Gradevinar“ t'i kompensohet dëmi që i është shkaktuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999.
14. Në të vërtetë, ndërmarrjes private „Gradevinar“ në gjysmën e dytë të vitit 1999 i është shkaktuar dëm që parashtruesi i kërkesës e ka vlerësuar të jetë 255,000,00 Euro, kurse bëhet fjalë për pronën e shkatërruar të cilën ndërmarrja private „Gradevinar“ e ka poseduar dhe e cila përbëhej prej: objekteve, pemishtes, të mbjellave, fitimeve të humbura për shkak të moskultivimit të tokës, ashtu sikurse edhe sendeve të luajtshme të cilat gjendeshin në objektet e përmendura.
15. Në kërkesë-padinë e parashtruar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës është thirrur në atë se përgjegjësia e të paditurve bazohet në nenin 180 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe Protokollin e Konventës që rregullon të drejtën e gëzimit paqësor dhe mbrojtjes së pronës.
16. Më 11 korrik 2007, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin IV. P.br. 11/2005 ka refuzuar kërkesë-padinë si të pabazuar në pjesën që i përket përgjegjësisë së Komunës-si e paditura e parë-me arsyetimin se „neni 180 i Ligjit për marrëdhënie detyrimore nuk parasheh përgjegjësinë e Komunës kur bëhet fjalë për shkatërrimin e pronës për shkak të luftës dhe veprimeve luftarake, sepse organet e Komunës gjithsesi nuk janë në gjendje të ndalojnë luftën, gjegjësisht agresivitetin në tërë vendin sikurse ka ndodhur në Kosovë gjatë vitit 1999“.
17. Me të njëjtin aktgjykim në lidhje me Institucionet e Përkohshme të Kosovës-si e paditura e dytë, dhe Qeveria e Kosovës-si e paditura e tretë, Gjykata [Ekonomike] e Qarkut në Prishtinë, padinë e parashtruar e **refuzoi** me arsyetimin se „sipas rregullores së UNMIKUT 2000/47 të 18 gushtit të vitit 2000, personeli i UNMIKUT gëzon imunitet“, ashtu sikurse edhe Qeveria e Kosovës-si e paditura e tretë „nuk mund të jetë palë në procedurë sepse në pajtim me nenin 77 të Ligjit të procedurës civile nuk ka status të personit juridik“.

18. Më 22 janar të vitit 2008, përmes avokatit Miro Delević ndërmarrja private „Građevinar” ushtron ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, në të cilën ndër të tjera thuhet se *“dëmi për të cilin ankohet i ka ndodhur pas 9 qershorit të vitit 1999, pas mbarimit të aksioneve luftarake ashtu siç ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabueshëm i të drejtës materiale nga vështrimi i legjitimitetit pasiv të të paditurit të dytë dhe të tretë”*.
19. Më 15 korrik 2010, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Ae-Pž br.21/2008 ka refuzuar si të **pabazuar** ankesën e avokatit Miro Delević, dhe **vërtetoi** Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë VI P-br. 11/2005, të 11 korrikut 2007.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pohon se me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën i është refuzuar kërkesë-padia e parashtruar e ndërmarrjes private „Građevinar“ që t’i kompensohet dëmi që i është bërë pas shkatërrimit të pronës së ndërmarrjes private „Građevinar“ gjatë vitit 1999, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës duke mos cekur konkretisht cilat nene të Kushtetutës i janë shkelur.
21. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“shkelja e të drejtave qëndron në faktin se në çdo kohë dhe në të gjitha rastet e drejta duhet të ekzistojë, dhe se ekzistenca e së drejtës gjithnjë ofron mbrojtje për personat fizikë dhe juridikë si dhe krijon çështjen e përgjegjësisë”*.
22. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se me aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme përkrahet vakuumi juridik nga aspekti i legjitimitetit pasiv të KFOR-it, UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës në këtë kontest.

Rregullat relevante kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me kontestet pronësore

23. Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore, në nenin 180, paragrafi 1, në vijim parasheh;

“Për dëmin e krijuar nga vdekja, për lëndimin trupor ose humbjen, përkatësisht shkatërrimin e pronës së personave fizik gjatë akteve të dhunës ose të terrorit, si dhe me rastin e demonstratave dhe manifestimeve publike, përgjigjet bashkësia organet e së cilës, sipas rregullave në fuqi, kanë qenë të detyruara të ndalojnë një dëm të tillë”.

Rregullat relevante kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e organeve qeveritare

24. Rregullorja nr. 1999/1, e 25 korrikut 1999, e cila përcakton autorizimin e udhëheqësisë së përkohshme në Kosovë, sipas nenit 1, paragrafi 1 dhe nenit 7 përcakton si në vijim:

1.1 Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm..

Kjo rregullore konsiderohet të ketë hyrë në fuqi më 10 qershor 1999, datë e miratimit të Rezolutës 1244 (1999) nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Rregullat relevante kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me imunitetin

25. Neni 146 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar] parashikon si në vijim:

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

1. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimin Gjithëpërfshirës duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.

26. Rregullorja nr. 2000/47, e datës 18 gusht të vitit 2000, që ka të bëjë me statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut si dhe personelit të tyre në Kosovë, me nenet 2.1 i 3.1 përcakton si në vijim:

2.1 KFOR-i, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij, janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor.

3.1 UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

27. Kushtet e pranueshmërisë janë të parapara me Kushtetutë, të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

28. Kërkesa e parashtruesit është në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, mënyra e llogaritjes së afateve kohore është përcaktuar në rregullin 27 pikat 3 dhe 6 të Rregullores së punës, të cilat parashikojnë si në vijim:

3. Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore, ose, nëse është e përshtatshme, në ditën e parë të muajit vijues;

6. Përndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.

29. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parashikon që:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

30. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk vepron si Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e instancave më të ulëta. Gjykatat më të ulëta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
31. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur prova *prima facie* me të cilat vërtetohet shkelja e të drejtave të tij kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se në cilat nene të Kushtetutës e mbështet kërkesën e tij, ashtu siç është paraparë në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
32. Parashtruesi i kërkesës pohon se i janë shkelur të drejtat me konstatimin e gabueshëm të fakteve dhe me zbatimin e gabueshëm të ligjit nga Gjykatat më të ulëta, parashtruesi i kërkesës pohon se gjykatat e instancave më të ulëta po i japin përkrahje “vakumit juridik”.
33. Nga dispozitat e lartpërmendura ligjore të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, të 25 korrikut 1999, me nenet 1.1 dhe 7.1 qartazi shihet se ai vakum ligjor nuk ekziston sepse rregullorja parasheh veprim retroaktiv prej 10 qershorit 1999, si dhe administratën e UNMIK-ut si të vetmin autoritet përgjegjës. Ndërsa Rregullorja nr. 2000/47 e 18 gushtit 2000, mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, sipas neneve 2.1 dhe 3.1 përcakton imunitetin e tyre në aspektin e pronës, fondeve dhe pasurisë së KFOR-it dhe UNMIK-ut nga çfarëdo procedure ligjore.
34. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin pohon se është i pasaktë, në Gjykatën Ekonomike të Qarkut dhe në Gjykatën Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
35. Përfundimisht, kjo kërkesë nuk i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri. Parashtruesi ka dështuar të theksojë dhe mbështesë me prova pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.
36. Nga kjo rezulton se kjo kërkesë është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës e cila parasheh që, “Gjykata duhet të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) e rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 tetor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari Raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani